



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

Ministria e Kulturës shpall konkursin për pozicionin Drejtor në Galerinë Kombëtare të Arteve

2017-10-03 13:42:00

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

NJOFTIM PËR KONKURIM PËR VEND PUNE

Datë 03.10.2017

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 173, datë 07.03.2003 “*Për emërimin, lirim ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose Ministrit*”, Ministria e Kulturës shpall konkursin për pozicionin:

Drejtor, në Galerinë Kombëtare të Arteve - Kategoria e pagës II-b.

Përshkrimi përgjithësues i punës për këtë pozicion:

Përgjigjet mbi hartimin dhe realizimin e politikave të artit pamor, si dhe për sigurimin e mbarëvajtjes së aktivitetit të Galerisë Kombëtare të Arteve, në kuadër të praktikave dhe menaxhimit, me qëllim që të mund të përmbushet misioni i Ministrisë, në fushën e galerive dhe ekspozitave.

Promovimi i veprave më të mira të artit pamor shqiptar të traditës dhe atij bashkëkohor kombëtar e ndërkombëtar, nëpërmjet grumbullimit, koleksionimit, konservimit, dokumentimit, studimit, restaurimit, ekspozimit dhe propagandimit të zhvillimit të vlerave të trashëgimisë kulturore.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e konkurimit publik:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejon të kryejë detyrën përkatëse;
- Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
- Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme sa vijon:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor”, në fushën e Arteve të Bukura, si dhe kualifikime të tjera shtesë në fushën e arteve;
- Të ketë aktivitet dhe përvoja ndërkombëtare në realizim ekspozitash;
- Të ketë përvoja kuratoriale dhe në menaxhim galerish;
- Të ketë njohuri shumë të mira të një gjuhe të BE.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- Jetëshkrimi CV;
- Fotokopje të diplomës dhe të listës së notave të noterizuara;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e kandidatit.

Kandidati duhet të propozojë një platformë në përgjigje të objektivave artistikë dhe të politikës kulturore.

Të ndërtojë një platformë nxitëse në funksion të programeve për zhvillimin e kulturës së arteve pamore.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave të bëhet brenda datës 16.10.2017, pranë Zyrës së Protokollit, në Ministrinë e Kulturës.